

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Propozimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 ‘Për taksat kombëtare’, të ndryshuar është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës. Ky projektligj është pjesë e paketës fiskale 2020.

Qëllimi i përgatitjes së këtij projektligji synon ndryshime lidhur me:

- saktësime të nevojshme që kanë ardhur si pasojë e zbatimit në praktikë të ligjit nga DPSHTRR-ja lidhur me aplikimin e dispozitave të këtij ligji;
- saktësimin e vlerës së mjetit për efekt të kriterëve që duhet të përmbushë një automjet për t’u konsideruar automjet luksi, duke e amortizuar vlerën e automjetit me 10% me vlerë të mbetur;
- ndryshime në penalitet me qëllim unifikimin e gjobës për pagesë të vonuar për taksën vjetore të mjeteve të përdorura;
- rritje të komisionit që përfiton DPSHTRR-ja, prej 5 (pesë) për qind për taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze;
- shtimin e kategorisë së personave me aftësi të kufizuar për t’u përjashtuar nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura;
- përjashtimin nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura, “Automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi”.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është i parashikuar në programin analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave në vitin 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektligj synon të rregullojë saktësime të nevojshme që kanë ardhur si pasojë e zbatimit në praktikë të ligjit, saktësimin e vlerës së mjetit për efekt të kriterëve që duhet të përmbushë një automjet për t'u konsideruar automjet luksi.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës..

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Ky projektligj nuk synon përafrimin e legjislacionit me *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në nenin 1 të projektligjit propozohen ndryshime të nenit 2, pika 5, ku përcaktohet përkufizimi i “Automjet luksoz”. Ky ndryshim synon saktësimin e vlerës së mjetit për efekt të kriterëve që duhet të përmbushë një automjet për t'u konsideruar automjet luksi. Aktualisht, në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, si dhe në pikën 2.11, të udhëzimit të ministrit të Financave nr.26, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, përcaktohet se “Automjet luksoz” konsiderohet autovetura deri në 6+1, e cila plotëson të paktën njërin nga kushtet e mëposhtme:

- a) cilindratën të barabartë ose më të madhe se 3000 cm³;
- b) vlerën/çmimin të barabartë ose më shumë se 5 000 000 lekë.

Me ndryshimet e propozuara në këtë projektligj synohet që në shkronjën “b” parashikohet që vlera e automjetit do të amortizohet çdo vit me 10% të vlerës së mbetur. Gjithashtu, është parashikuar se vlera e shitjes së automjeteve të klasifikuara si “Automjet luksoz” nuk mund të jetë më e vogël se vlera e mjetit të amortizuar sipas amortizimit të lartpërmendur.

Ky propozim vjen si shkak i një numri të konsiderueshëm të kërkesë-padive në DPSHTRR, në lidhje me uljen vit pas viti të vlerës/çmimit të mjeteve të klasifikuara si mjete luksi. Të tilla kërkesa-padi apo ankesat nga pronarët e mjeteve për vlerën/çmimin e mjetit janë një numër i konsiderueshëm në

DPSHTRR, fakt ky i cili ngarkon me kosto financiare që rëndojnë statusin e DPSHTRR-së, si person juridik, publik, i cili vetëfinancohet.

Për këto arsye, propozohet që të shtohet në shkronjën “b” së vlera e automjetit do të amortizohet çdo vit me 10% të vlerës së mbetur dhe vlera e shitjes së automjeteve të klasifikuara si “Automjet luksoz” nuk mund të jetë më e vogël se vlera e mjetit të amortizuar sipas amortizimit të lartpërmendur.

Në nenin 2 propozohen ndryshime në pikën 3, të nenit 4, “Niveli i taksave kombëtare”. Ky propozim synon ndryshime në penalitet me qëllim unifikimin e gjobës për pagesë të vonuar për taksën vjetore të mjeteve të përdorura me gjoba të vendosura për detyrime tatimore të së njëjtës natyrë, të parashikuara në ligjin për procedurat tatimore. Gjithashtu, unifikohet përqindja e të ardhurave vjetore nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura që i kalojnë pushtetit vendor me përcaktimet e ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Në nenin 4, pika 3, e ligjit aktual “Për taksat kombëtare” përcaktohet “... Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 25 për qind për çdo vit. 18 për qind e të ardhurave vjetore nga kjo taksa i kalojnë buxhetit të qeverisjes vendore. Procedura e ndarjes të të ardhurave me buxhetet e njësive të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore.”

Me ndryshimet e propozuara në këtë projektligj bëhet zëvendësimi i fjalëve “prej 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 25 për qind për çdo vit” me “sipas nenit 114 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, dhe fjalët “18 për qind” me “25 për qind”.

Në nenin 3 propozohet riformulimi i nenit 7 “Taksa që vilet nëpërmjet pullës”, ku, “janë taksa vjetore e mjeteve të përdorura dhe” zëvendësohen me fjalën “është”.

Në nenin 4 propozohen ndryshime të nenin 8, ku përcaktohen “Komisionet që përfitojnë agjentët e taksave”. Ky ndryshim synon rritje të komisionit që përfiton DPSHTRR-ja, prej pesë për qind për taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze. Në nenin 8, pika 2, shkronja “g”, aktualisht përcaktohet se për taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze, zero për qind.

Me ndryshimet e propozuara në këtë projektligj, taksa e regjistrimit fillestar dhe taksa e përvitshme për automjetet luksoze bëhet pesë për qind.

Ky propozim vjen për arsye se DPSHTRR-ja duke qenë me statusin e personit juridik, publik, i cili vetëfinancohet dhe nga ana tjetër kostot janë relativisht të larta për ndryshime të kriterëve për klasifikimin e mjetit si “automjet luksoz” në sistemin informatik. Mungesa e të dhënave për vlerën e mjetit në sistemin informatik të DPSHTRR-së ka bërë që puna për kontrollin, plotësimin dhe saktësimin e vlerës së mjetit, për të gjitha ato mjete të cilat mendohej se mund të klasifikohen si “automjet luksoz”, janë realizuar shpenzime përkatëse të konsiderueshme sidomos në burime njerëzore, në një kohë që DPSHTRR-ja si agjent nuk përfiton asnjë të ardhur nga kjo taksë. Gjithashtu, DPSHTRR-ja, për të realizuar arkëtimin e taksave dhe për të qenë sa më afër taksapaguesve ka hapur zyra edhe në rrethe të tjera.

Për sa më lart propozohet ndryshimi i shkronjës “g”, ku taksa e regjistrimit fillestar dhe taksa e përvitshme për automjetet luksoze bëhet pesë për qind.

Në nenin 5 propozohen ndryshime dhe shtesa të nenit 9 “Përrjashtimi nga pagimet e taksave kombëtare”. Këto propozime synojnë shtimin e kategorisë së personave me aftësi të kufizuara për t’u përrjashtuar nga taksat vjetore të mjeteve të përdorura dhe përrjashtimin nga pagimi i taksës vjetore të automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Në ligjin në fuqi përrcaktohet në pikën 1, shkronja “ç”, të nenit 9, “autoveturat tip deri në 4+1 vende dhe me cilindratë jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përrkatëse, dhe përrdoren vetëm për nevojat e tyre personale e jo për veprimtari private”.

Konkretisht propozohet që pas fjalëve “individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë” të shtohen “personat me aftësi të kufizuar” dhe njëkohësisht shtohen fjalët “përrjashtim i automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi”, në pikat 1, dhe 7, të nenit 9.

Propozimi për shtimin e fjalëve “persona me aftësi të kufizuara” mbështetet në zbatim të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, vendimit nr.618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përrcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masën e përrfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar, si dhe në vendimin e KMCAP-it për pajisjen me librezën përrkatëse nga Shërbimi Social Shtetëror.

Propozimi për përrjashtimin e automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi do të ketë një impakt kulturor dhe social për të apasionuarit e

automobilizimit brenda dhe jashtë vendit. Në vështrim të turizmit, Shqipëria mund të ofrojë një flotë mjetesh nga vendet e Lindjes që nuk gjenden në regjistrat e shoqatave perëndimore të automobilizimit.

Kjo nismë ligjore vjen në përputhje dhe me programin politik të qeverisë, përkatësisht të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim 2014-2020 dhe mund të nxisë zhvillimin e sektorit të mekanikës, duke nxitur më shumë të rinjtë që t'i drejtohen shkollave profesionale duke u kualifikuar në rregullimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve rrugore të hershme.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij akti janë Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe DPSHTRR-ja.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe është bashkërenduar me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji parashkon efekte negative të cilat nuk mund të përlllogariten për shkak të natyrës të ndryshimeve ligjore.

KËSHILLI I MINISTRAVE